



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2019

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbajtur, më 05.06.2019)

Pika 1 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i kërkesës së gjyqtarit, z. {...}, përgatitur nga Komisioni i Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 15:35 dhe mbaroi në orën 16:54.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Illir Toska*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Brikena Ukperaj*** (anëtar)
10. ***Erjon Muharremaj*** (anëtar)
11. ***Marçela Shehu*** (anëtare)

Merrnin pjesë gjithashtu:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
2. *Antuen Skënderi, Këshilltare e Kabinetit pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
3. *Pjerin Prendi, Këshilltar i Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
4. *Vildan Kaloshi, Drejtor pranë institucionit.*
5. *Valbona Bako, Specialiste pranë institucionit.*
6. *Elis Kuçi, Specialist pranë institucionit.*
7. *Edlira Bako, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
8. *Migena Kondo, Komiteti Shqiptar i Helsinkit.*
10. *Klara Kodra, Qendra Evropiane.*
11. *Gregor Borgowski, EURALIUS.*
12. *Klodian Rado, EURALIUS.*
13. *Valbona Bala (Pajo), USAID.*
14. *Erion Fejzulla, USAID.*

RENDI I DITËS:

1. Shqyrtimi i kërkesës së gjyqtarit, z. {...}, përgatitur nga Komisioni i Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale.

Naureda Llagami: Atëherë, përshëndetje!

Siç jeni vënë në dijeni, po fillojmë mbledhjen e datës 5 qershor 2019.

Në radhë të parë ju kërkoj ndjesë të gjithë përfaqësuesve dhe misioneve dhe të gjithë monitoruesve të seancës së sotme për vonesën tonë, por dhe ne e kishim situatën pak emergjente në rendin e ditës, kështu që, edhe njëherë kërkoj ndjesë për vonesën.

Siç jeni vënë në dijeni, lidhur me çështjet që do diskutohen sot në rendin e ditës, kemi parashikuar 5 çështje. Çështja e parë lidhur me një kërkesë të paraqitur nga gjyqtari {...}. Çështja e dytë ka të bëjë lidhur me caktimin e relatorit për verifikimin e kushteve dhe kriterëve për kandidatët për gjyqtarë të diplomuar në Shkollën e Magjistraturës.

Çështja e tretë është për caktimin e relatorit për verifikimin e kushteve dhe kriterëve për secilin kandidat që do marrë pjesë në formimin fillestar të Shkollës së Magjistraturës për vitin akademik 2019-2020. Çështja e katërt ka të bëjë me caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera të ndryshme nga ato ku ushtrojnë funksionin në mënyrë të përhershme. Dhe kemi dhe një pikë tjetër, e cila janë “Të tjera”, që në këtë pikë do të bëhet me dyer të mbyllura, për shkak të informacionit që ka në çështje “Të tjera” dhe është informacion i kualifikuar.

Atëherë pa humbur kohë, le të fillojmë më çështjen e parë të rendit të ditës, për të cilën unë dëshiroj t’ia japë fjalën kryetares së Komisionit për Vlerësimin Etik dhe Profesional, zonjës Ukperaj, për relatimin e projekt-aktit. Faleminderit!

Brikena Ukperaj: Faleminderit, zonja Kryetare!

Atëherë, fillimisht dua të prezantoj shkaqet e nisjes së kësaj procedure administrative nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale në Këshill. Siç jeni njohur dhe nga materialet bashkëngjitur relacionit, në datën 29.05.2019, në Këshillin e Lartë Gjyqësor, është depozituar një kërkesë e gjyqtarit të Gjykatës së Apelit Tiranë, zotit {...}, njëkohësisht dhe anëtar i Kolegjit Zgjedhor që funksionon pranë së njëjtës gjykatë me lëndë: “Mbi caktimin tim në shortin e Kolegjit Zgjedhor”. Me anë të kësaj kërkesë gjyqtari ka kërkuar KLGJ-së, sqarimin e një situatë ekuivoke sipas tij të krijuar në kolegjin zgjedhor, për shkak se edhe pse për të ka të miratuar një leje prindërore nga ish-Këshilli i Lartë i Drejtësisë, nga ana e drejtuesit të Gjykatës së Apelit, i është komunikuar se, ai nuk është përjashtuar nga shorti për përzgjedhjen e trupit gjykues dhe relatorin e çështjeve të regjistruara në Gjykatën e Apelit Tiranë për kompetencë të shqyrtimit të Kolegjit Zgjedhor.

Gjyqtari ka parashtruar se nuk është jo vetëm logjike por as ligjore pjesëmarrja e tij në përfshirjet e tij në çështjet në shqyrtim në Kolegjin Zgjedhor, duke dhënë një sërë argumentash që kanë lidhje kryesisht me lejen prindërore 2-vjeçare, të miratuar. Papajtueshmërinë e ushtrimit njëkohësisht edhe të detyrës së gjyqtarit dhe të anëtarit të kolegjit, ndërkohë që ai është me leje prindërore të papaguara. Rrethana familjare që lidhen kryesisht me lejen prindërore për fëmijën e porsalindur dhe jetesën e tyre familjarisht në Bavari, ku janë të pajisura me leje qëndrimi.

Veç kërkesës së gjyqtarit, pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor është depozituar në datën 31.05.2019 dhe një kërkesë tjetër që ka të bëjë me një shqetësim të krijuar aktualisht në Kolegjin Zgjedhor të Gjykatës së Apelit, me anë të së cilës 6 anëtarë të këtij kolegji, kanë njoftuar se, referuar nenit 147 të Kodit Zgjedhor është thirrur nga kryetari i Gjykatës së Apelit Kolegji Zgjedhor që funksionon pranë kësaj gjykate, për shkak se janë depozituar disa padi nga individë dhe parti politike në lidhje me zgjedhjet vendore të datës 30.06.2019. Në këtë kërkesë sqarimi, anëtarët e kolegjit informojnë Këshillin se në tre nga këto çështje, është zgjedhur si anëtar në përbërje të trupave gjyqësore, gjyqtari {...}. Të tre këto çështje janë planifikuar për t'u gjykuar në datën 30.05.2019 por seancat gjyqësore janë shtyrë për shkak të mos formimit të trupit gjyqësor, pasi gjyqtari {...} nuk është paraqitur në punë.

Është komunikuar nga ana e tyre nëpërmjet telefonit me gjyqtarin dhe ai ka informuar se ndodhet në Gjermani dhe i është drejtuar KLGJ-së me shkresë për interpretimin e vendimit nr. 52, datë 10.11.2018 të KLD-së, nëse do të marrë pjesë apo jo në përbërje të trupave gjyqësore të Kolegjit Zgjedhor.

Duke marrë shkas nga afatet e ngutshme procedurale, që janë parashikuar në Kodin Zgjedhor lidhur me gjykimin e padive, dhe vetë rëndësinë që ka shqyrtimi i këtyre çështjeve, me urgjencë, nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës është trajtuar rasti dhe kemi arritur dhe në konkluzionet përkatëse.

Fillimisht dua t'ju informoj lidhur me statusin profesional të gjyqtarit {...}. Aktualisht gjyqtari {...} ushtron funksionin e gjyqtarit të gjykatës së apelit në Gjykatën e Apelit Tiranë, dhe në zbatim të nenit 146 të Kodit Zgjedhor miratuar me ligjin 1019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, ai është përzgjedhur me short si një nga anëtarët e Kolegjit Zgjedhor të Gjykatës së Apelit Tiranë.

Në datë 11.12.2018 me anë të një kërkesë drejtuar Kryetarit të KLD-së, Presidentit të Republikës së Shqipërisë, gjyqtari {...} ka kërkuar mbështetur në nenin 24 të ligjit 96/2016, "leje prindërore" për shkak se në datën 16.08.2018 ka ardhur në jete vajza e tij. Në këtë kërkesë ka shpjeguar se vajza ka ardhur në jetë në Gjermani dhe është me shtetësi gjermane. Ai dhe bashkëshortja kanë rezidencë gjermane gjithashtu dhe se qëndrimi jashtë këtij vendi në një vend jo të BE-së sikundër ishte Shqipëria, nuk mund të

ishite më shumë se 3 muaj. Në kërkesë veç nevojave për të qenë pranë fëmijës 2 vitet e para pas ardhjes në jetë, shprehet gatishmëria e gjyqtarit që për periudhën 2-vjeçare të miratimit të lejes, të ishte prezent në mbledhjet e KLD-së deri në datën e funksionimit të tij si organ kushtetues dhe garantonte gjithashtu edhe pjesëmarrjen e tij në Kolegjin Zgjedhor të Gjykatës së Apelit Tiranë. Në kërkesë ai ka kërkuar konkretisht “leje prindërore të papaguar” për t’u shkëputur nga angazhimi ditor gjyqësor vetëm në gjykimet në Gjykatën e Apelit Tiranë.

Kërkesa e mësipërme është shqyrtuar në mbledhjen e KLD-së në të njëjtën ditë, në datën 11.10.2018 si pikë 3 shtesë e rendit të ditës dhe është vendosur miratimi i kërkesës për leje prindërore për një periudhë 2-vjeçare, gjyqtarit {...}, për funksionin si gjyqtar pranë Gjykatës së Apelit Tiranë. Afati i kësaj leje fillon më datë 01.11.2018 deri më 31.10.2020.

Në pjesën hyrëse të vendimit parashikohet konkretisht: “Këshilli i Lartë i Drejtësisë i mbledhur në datë 11.10.2018, bazuar në nenin 24 të ligjit 96/2016, pasi shqyrtoi kërkesën e gjyqtarit {...}, regjistruar me aktin 2917 prot., datë 11.10.2018, i cili për shkak të lindjes së vajzës së tij, e cila së bashku me bashkëshorten janë me shtetësi gjermane dhe rezidente në Gjermani, kërkon leje prindërore, për funksionin si gjyqtar pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, por të vijojë ushtrimin e detyrës së anëtarit të KLD-së dhe të Kolegjit Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë”.

Aktualisht gjyqtari {...} vazhdon të jetë me leje prindërore, por siç u shpjegua me lart, është përfshirë në shortin e Kolegjit Zgjedhor, sepse leja prindërore sipas vendimit të mësipërm dhe kërkesës së vetë gjyqtarit i është miratuar vetëm për funksionin si gjyqtar pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, duke u lejuar vijimi i ushtrimit prej tij te detyrës si anëtar i KLD-së dhe Kolegjit Zgjedhor.

Lidhur me lejen prindërore, ajo është një risi e ligjit 96/2016, mbështetur konkretisht në ndryshimet që ka pësuar Kodi i Punës në shtesën që i është bërë këtij Kodi me nenin 132/1 të tij, me të cilin jemi familjarizuar për shkak edhe të një vendimi të marrë së fundi nga ana e Kolegjit lidhur me lejet e papaguara të gjyqtarëve.

Krahas kësaj dispozite, në Kushtetutë parashikohet që, në nenin 54 të saj, që: *Fëmijët, të rinjtë, gratë shtatzëna dhe nënat e reja kanë të drejtën e një mbrojtjeje të*

veçantë nga shteti dhe interesi më i lartë i fëmijës ka përparësi në të gjitha çështjet që lidhen me të.

Në zbatim të këtyre dy dispozitave kemi vlerësuar që të drejtën e përfitimit të lejes prindërore, ashtu sikundër çdo punëmarrës, e ka edhe çdo gjyqtar, për shkak të referencës që bën neni 24 i ligjit “Për statusin...” tek Kodi i Punës, që plotëson të njëjtat kritere të vendosura pra në Kodin e Punës.

Me vendimin nr. 72, datë 20.05.2019 KLGJ ka miratuar edhe rregulla shtesë “Mbi lejet e papaguara të gjyqtarëve”. Sipas këtij vendimi “leja” është përkufizuar si autorizimi me shkrim që jep Këshilli i Lartë Gjyqësor, për gjyqtarin, që ai të mos paraqitet në punë për një periudhë të caktuar kohore. Është parashikuar gjithashtu që: “Lejet e papaguara të dhëna nga ish-Këshilli i Lartë i Drejtësisë, do të vazhdojnë të zbatohen sipas kushteve të vendosura në to”.

Në rastin konkret është për t’u theksuar se ndryshimet e mësipërme të ndodhura në Kodin e Punës, apo parashikimet në ligjin 96/2016 në lidhje me statusin e gjyqtarit, duke qenë se janë të mëvonshme, nuk gjejnë pasqyrim në Kodin Zgjedhor, prandaj nuk mund t’i refuzohet “leja prindërore” një anëtar i Kolegjit Zgjedhor me arsyetimin se ajo nuk parashikohet në Kodin Zgjedhor. Nga ana tjetër, gjyqtarit që plotëson kushtet e nenit 132/1 të Kodit të Familjes, për shkak të nenit 54 pika 4 të Kushtetutës por dhe parashikimit ligjor, nuk mund t’i refuzohet “leja prindërore”, pavarësisht dëmtimit ose jo të funksionalitetit të gjykatës apo përgjegjësive të tjera që lidhen me të qenit gjyqtar, si në rastin konkret anëtar i Kolegjit Zgjedhor. Pra është parimi i pamundësisë për të revokuar, për të refuzuar lejen prindërore në qoftë se gjyqtari plotëson kushtet.

Akti i KLGJ-së që miraton “lejen prindërore” në thelb përbën një akt administrativ individual, sepse lidhet me statusin profesional të gjyqtarit. Si i tillë ai i nënshtrohet dispozitave të Kodit të Procedurave Administrative, në lidhje me shfuqizimin, anulimin, ndryshimi, plotësimin, madje edhe për konstatimin e pavlefshmërisë absolute të tij. Nga ana tjetër, ky akt mund të përbëjë edhe objekt rishikimi me kërkesë të palës sipas neneve 144 dhe 146 të Kodit të Procedurave Administrative.

Nga ana tjetër lidhur me funksionin e anëtarit të Kolegjit Zgjedhor, me qëllim shqyrtimin në rrugë gjyqësore të ankimeve të subjekteve zgjedhore, individëve apo partive politike, ndaj vendimeve të KQZ-së, pranë Gjykatës së Apelit, funksionon Kolegji Zgjedhor, i përbërë nga 8 anëtarë të caktuar me short. Kodi Zgjedhor në fakt i referohet KLD-së si një organ që organizon shortin, për shkak se siç u përmend më lart, në të nuk janë pasqyruar ndryshimet e ndodhura me ligjet e mëpasshme. Në short marrin pjesë të gjithë gjyqtarët e gjykatave të apeleve me përjashtim të atyre ndaj të cilëve është vendosur fillimi i çështjes penale, është në fuqi një masë disiplinore apo ka filluar procedimi disiplinor. Funksioni i anëtarit të Kolegjit Zgjedhor lidhet pazgjidhshmërisht me atë të gjyqtarit të Apelit. Pavarësisht se sipas nenit 147, pika 1 të Kodit Zgjedhor, Kolegji Zgjedhor i ushtron funksionet gjatë gjithë legjislaturës së Kuvendit të dala nga zgjedhjet dhe funksionon për të gjitha llojet e zgjedhjeve, ai thirret nga Kryetari i Gjykatës së Apelit Tiranë vetëm në rast se kur pranë kësaj të fundit regjistrohen padi që kanë të bëjnë me zgjedhjet, siç kundër janë edhe çështjet e regjistruara në rastin konkret në kuadër të zgjedhjeve vendore. Anëtarët e Kolegjit Zgjedhor të Gjykatës së Apelit Tiranë, e ushtrojnë këtë funksion sa herë është e nevojshme brenda veprimtarisë së tyre gjyqësore, -është një konkluzion që është i nevojshëm për t'u theksuar, sepse nuk mund të ketë ndarje të veprimtarisë gjyqësore midis gjyqtarit që ushtron funksionin në Gjykatën e Apelit dhe gjyqtarit që ushtron funksionin pranë Kolegjit Zgjedhor. Në të dyja rastet, ushtrimi detyrës së gjyqtarit është brenda veprimtarisë gjyqësore që kryen gjyqtari. Prandaj miratimi i një "leje prindërore" të një gjyqtari të përzgjedhur nga shorti si anëtar i Kolegjit Zgjedhor, në kushtet kur leja prindërore nuk mund t'i refuzohet për këtë shkak, por vetëm mund t'i shtyhet deri në 6 muaj, automatikisht do të prodhojë në parim të njëjtat pasoja si për veprimtarinë normale gjyqësore ashtu edhe atë të Kolegjit Zgjedhor, pra do të sjellë ndërprerje të gjithë veprimtarisë gjyqësore të gjyqtarit brenda afatit të caktuar në vendimin e miratimit të lejes.

Çështjet që u shtruan për zgjidhjen për diskutim në rastin konkret, ishte nëse: A mundet KLGJ të ushtrojë rishikimin me kërkesë apo të investohet qoftë edhe kryesisht për shqyrtimin e vlefshmërisë apo ligjshmërie së akteve administrative individuale të

nxjerra nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë në kuadër të ligjit 96/2016, t'i ndryshojë apo plotësojë ato?

Në Komision kemi vlerësuar se në kuadër të vazhdimësisë dhe koherencës institucionale, brenda kompetencave kushtetuese dhe ligjore, nuk ka asnjë pengesë që Këshilli i Lartë Gjyqësor të rishikojë me kërkesë apo të investohet qoftë edhe kryesisht për shqyrtimin e vlefshmërisë apo ligjshmërisë së akteve administrative individuale të KLD të nxjerra në zbatim të ligjit 96/2016, t'i ndryshojë apo plotësojë ato, por nuk mund të interpretojë sikurse pretendohet në kërkesë vendimet e ish-KLD-së. Rregulli i vendosur në vendimin nr. 72, datë 20.05.2019 “Mbi lejet e papaguara të gjyqtarëve që jepen nga KLGJ”, për zbatimin e vendimeve të ish-KLD para hyrjes në fuqi të vendimit sipas kushteve të miratuara në to, nuk përbën pengesë për ndryshimin e akteve administrative individuale në lidhje me statusin profesional të gjyqtarit, në rast të ndryshimit të rrethanave që kishin ekzistuar në momentin e miratimit të tij.

Problemi i dytë që është diskutuar në Komision është: Si duhet interpretuar dhe vlerësuar kërkesa e gjyqtarit në rastin konkret dhe njëkohësisht edhe shqetësimi i 6 anëtarëve të Kolegjit Zgjedhor të Gjykatës së Apelit?

Nga përmbajtja e kërkesës së paraqitur në KLGJ nuk përcaktohet në mënyrë të qartë se cili është objekti i kërimit të gjyqtarit, në kushtet kur akti i referuar, vendimi nr. 52, datë 11.10.2018 është marrë në përputhje me kërkesën e gjyqtarit. Pra në thelb ka një marrëveshje sipas asaj që kërkon neni 132/1 i Kodit të Punës midis gjyqtarit dhe KLD-së, në momentin e nxjerrjes së aktit, për ndarjen e veprimtarisë gjyqësore të gjyqtarit gjatë kohëzgjatjes së lejes prindërore. Por ajo që arrihet të identifikohet si qëllim i kësaj kërkesë është “ndryshimi i vullnetit të gjyqtarit mbi kushtet e lejes prindërore”, e thënë ndryshe një kërkesë e tij për të ndryshuar këtë klauzolë të marrëveshjes. Në kërkesën për leje prindërore ai ka kërkuar leje prindërore për t'u shkëputur nga veprimtaria e përditshme gjyqësore e gjyqtarit të Gjykatës së Apelit Tiranë, duke u treguar i gatshëm për të vijuar detyrën e anëtarit të Kolegjit Zgjedhor e mos penguar funksionalitetin e këtij Kolegji. Ndërsa sot, me këtë kërkesë të re drejtuar KLGJ, ky vullnet tashmë rreth 7 muaj më pas, nuk ekziston. Nga ana tjetër, siç u interpretua edhe më lart, leja prindërore e papaguar, sjell ndërprerje të veprimtarisë gjyqësore të gjyqtarit dhe nuk mund t'i

refuzohet atij për shkak të qenies anëtar i Kolegjit Zgjedhor. Punëdhënësi ka vetëm të drejtën e shtyrjes së fillimit të afatit të lejes, por tashme ky moment ka kaluar pasi leja ka filluar të prodhojë pasojat e saj që në datë 01.11.2018. Ndërsa ndarja e lejes në kuptim të nenit 132/1 të Kodit të Punës, nuk nënkupton ndarjen e veprimtarisë gjyqësore por ndarjen e periudhës kohore për të cilën jepet leja prindërore. Në këto kushte, kemi vlerësuar se ndodhemi para ndryshimit të rrethanave për të cilat është miratuar fillimisht leja prindërore për gjyqtarin {...}.

Komisioni ka vlerësuar se kërkesa e gjyqtarit, por edhe shqetësimi i gjyqtarëve të Kolegjit Zgjedhor të Gjykatës së Apelit Tiranë, lidhur me situatën problematike të krijuar për shkak të shtyrjes së seancave gjyqësore sepse gjyqtari nuk paraqitet në punë me arsye se është me leje prindërore është trajtuar në kuadër të nenit 144 të Kodit të Procedurave Administrative, pasi pavarësisht emërimit të shkresës, në thelb, kërkohet ndryshimi i një akti administrativ të nxjerrë, ndërkohë që gjithë procedura administrative është ajo i rishikimit të aktit administrativ, parashikuar nga neni 144, 145 dhe 146 të Kodit të Procedurave Administrative.

Për sa u relatua më lart, bazuar në gjendjen faktike dhe interpretimin ligjor, në zbatim të neneve 132/1 të Kodit të Punës, nenit 24 të ligjit 96/2016, nenit 144 dhe 146 të Kodit të Procedurave Administrative, në kushtet kur ka ndryshuar një rrethanë thelbësore që lidhet jo vetëm me lejen prindërore të miratuar të gjyqtarit, por edhe me funksionalitetin e Kolegjit Zgjedhor, të tilla që nëse do të ekzistonin rrethanat aktuale, do ta bënin të paligjshëm aktin administrativ, pasi gjyqtari që i miratohet “leja prindërore” ndërpret çdo veprimtari gjyqësore dhe nuk mund të ketë ndarje të kësaj veprimtarie në një veprimtari të lejuar që mund të ushtrohet brenda lejes prindërore dhe një veprimtari që nuk mund të ushtrohet brenda saj, Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale propozon: Ndryshimin e vendimit nr. 52, datë 11.10.2018 të ish-KLD-së, në pikën 1 të tij, duke shfuqizuar togfjalëshin “për funksionin si gjyqtar pranë Gjykatës së Apelit Tiranë”.

Konkretisht, efektet ligjore që do të sjellë ky vendim është vazhdimi i efekteve të lejes prindërore pa kufizim për gjyqtarin, si për sa i përket veprimtarisë gjyqësore

normale të tij si gjyqtar i Gjykatës së Apelit, ashtu edhe për sa i përket veprimtarisë gjyqësore të tij si anëtar i Kolegjit Zgjedhor.

Naureda Llagami: Faleminderit, zonja Ukperaj!

Para se ta kalojmë projekt-aktin për votim, ju lutem, jeni të ftuar për diskutime apo komente lidhur me projekt-aktin.

Po, zoti Toska!

Ilir Toska: Faleminderit!

E mora fjalën thjesht për të thënë arsyetimin tim në lidhje me projektvendimin e paraqitur nga Komisioni i Vlerësimit Etik dhe Profesional, sa i përket ndryshimit të vendimit të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe shfuqizimit të një prej urdhërimeve të tij, sa i përket kushtit në lidhje me dhënien e lejes prindërore për gjyqtarin e Gjykatës së Apelit Tiranë, zotin {...}.

Në vlerësimin tim, siç e ceku pak edhe relatorja e çështjes, kjo gjë duhet të ndodhë për shkak të vënies në funksionim të Kolegjit Zgjedhor, e thënë këtë, kam parasysh Kodin Zgjedhor por edhe ligjin “Për statusin e gjyqtarit” mbi të cilën është akorduar leja për zotin {...}.

Referuar vendimit të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë, leja është dhënë në bazë të nenit 24 të ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në këtë dispozitë, në pikën 4 thuhet: *“Këshillat mund të japin lejen e papaguar pasi të kenë marrë mendimin e kryetarit të gjykatës ose prokurorisë, nëse leja nuk bie ndesh me interesat kryesorë të funksionit dhe nuk vë në rrezik në tërësi përmbushjen e funksionit me efikasitet dhe në kohë, në gjykatë ose në prokurori.”*

Referuar këtij rregullimi ligjor, konsideroj apo kam të drejtën të mendoj se zoti {...}, në rastin kur ka paraqitur kërkesën për “leje prindërore” por edhe ish-Këshilli i Lartë i Drejtësisë ka pasur parasysh pikërisht këtë rregullim të bërë në ligjin “Për statusin e gjyqtarit” ku ka konsideruar dhënien e lejes së papaguar prindërore për një periudhë 2-vjeçare, por ndërprerje të kësaj leje gjatë periudhës kur Kolegji Zgjedhor mblidhej për shkak të zgjedhjeve që mund të ndodhnin gjatë periudhës kur Kolegji Zgjedhor do të ushtronte mandatin e tij.

Në Kodin Zgjedhor është parashikuar që Kolegji Zgjedhor zgjidhet një herë në 4 vjet dhe numri i anëtarëve është 8. Kodi Zgjedhor ka konsideruar që ky numër nuk ndryshon në asnjë rast, përfshirë edhe rastin kur një nga anëtarët e Kolegjit Zgjedhor mund të jetë zgjedhur si anëtar i Kolegjit në kundërshtim me dispozitën urdhëruese të ligjit, të Kodit Zgjedhor. Në këtë rast, Kodi ka parashikuar që ai vijon të jetë anëtar, por nuk merr pjesë në gjykimin e mosmarrëveshjes zgjedhore. Besoj që ish-Këshilli i Lartë i Drejtësisë ka pasur në konsideratë të gjithë këtë situatë që e përcakton Kodi Zgjedhor, ku ka përcaktuar një numër të kufizuar të gjyqtarëve; ka pasur në konsideratë se vetëm pak ditë më parë një prej anëtarëve të Kolegjit Zgjedhor është pezulluar nga detyra për shkak të ligjit, për shkak të procesit të rivlerësimit, dhe dhënia e lejes prindërore, duke përfshirë edhe mos ushtrimin e funksionit të gjyqtarit të Kolegjit Zgjedhor, do të çonte Kolegjin Zgjedhor në situatë jo funksionale.

Duke ardhur sot, jemi përpara situatës ku nga Kolegji Zgjedhor, gjyqtarët në detyrë, informohemi që Kolegji Zgjedhor funksionon vetëm me 6 gjyqtarë, pasi zoti {...} nuk paraqitet në detyrë. Nga ana tjetër, për shkak se nuk është i përjashtuar nga pjesëmarrja në Kolegjin Zgjedhor, zotit {...} i janë ngarkuar për të shqyrtuar disa çështje gjyqësore, të cilat janë shtyrë, referuar informacionit nga gjyqtarët në detyrë të Kolegjit Zgjedhor, duke kapërcyer edhe afatin 10-ditor për të cilin Kodi Zgjedhor përcakton për Kolegjin Zgjedhor, për të shqyrtuar mosmarrëveshje zgjedhore përpara datës së zgjedhjeve.

Referuar pikërisht kësaj situatë, çmoj që duhet të shfuqizohet vendimi sa i përket dhënies së lejes prindërore me kusht, pikërisht për kushtin, për të bërë funksional Kolegjin Zgjedhor. Përndryshe, të gjitha çështjet që tashmë i kanë rënë në short zotit {...} apo çdo çështje që do t'i bie në të ardhmen, do të vazhdojnë të jenë të bllokuara dhe Kolegji Zgjedhor do të jetë jashtë funksionit dhe nuk do të përmbushë veprimtarinë e tij. Faleminderit!

Naureda Llagami: Atëherë, Faleminderit, zoti Toska!

Ndonjë koment, sugjerim?

Po, zonja Ukperaj!

Brikena Ukperaj: Jam dakord me çka u relatua nga zoti Toska, por ajo çka u relatua është thjesht një konsekuencë ose një pasojë juridike që do të krijojë ky vendim në fakt. Sepse, leja prindërore, në ndryshim nga çdo leje tjetër e papaguar, nuk mund t'i refuzohet gjyqtarit nëse ai plotëson kushtet dhe nuk ndikohet nga cenimi... nuk mund t'i refuzohet për shkak të cenimit të funksionalitetit të gjykatës ku gjyqtari ushtron funksionin. Punëdhënësi mundet thjesht të ndajë lejen prindërore dhe të shtyjë afatin e marrjes së lejes prindërore. Nga ana tjetër, gjyqtarit nuk mund t'i thuhet që ti për një pjesë të veprimtarisë gjyqësore do të vish në detyrë (pavarësisht se çfarë natyre ka kjo veprimtari gjyqësore) dhe për një pjesë tjetër të veprimtarisë gjyqësore nuk do të vish në detyrë. Në kuadër kur kemi një leje të papaguar dhe gjyqtari prezanton vullnetin që, sikundër ka ekzistuar, nuk mund të paraqitet sepse ai do të kujdeset, do të vazhdojë nën efektet e lejes prindërore, nuk mundet dot që gjatë kësaj periudhe kohore të vazhdonte kushti, në qoftë se do ta quajmë kështu, i vendosur në vendim për dhënien e lejes prindërore vetëm për sa i përket veprimtarisë ose funksionit të gjyqtarit si gjyqtar i Gjykatës së Apelit, duke e marrë të veçuar funksionin e gjyqtarit të Kolegjit Zgjedhor. Procedura e rishikimit në këtë rast është iniciuar nga vetë gjyqtari dhe në kuadër të Kodit të Procedurave Administrative është një procedurë rishikimi që nuk mund ta bëjë kryesisht organi, në qoftë se nuk ka një kërkesë të prezantuar nga vetë subjekti i aktit administrativ individual, që në rastin konkret kemi të bëjmë me gjyqtarin. Prandaj u trajtua nga ana e Komisionit në kuadrin e parimeve që sigurohen në ligj për sa i përket lejes prindërore dhe efekteve që do të kishte kjo në kuadër të veprimtarisë gjyqësore që ushtronte gjyqtari. Pastaj, pasojat që do të krijojë ky vendim, është ajo që zoti Toska prezanton, pikërisht me anë të këtij vendimi, jo vetëm garantohet ushtrimi i lejes prindërore, por edhe shmanget cenimi i funksionalitetit të Kolegjit Zgjedhor.

Naureda Llagami: Po, zoti Toska!

Ilir Toska: Atëherë, e mora prapë fjalën për të theksuar diçka tjetër.

Unë kam mendimin që duhet të ndryshohet vendimi, të shfuqizohet kushti për dhënien e lejes prindërore, për shkak se Këshilli i Lartë Gjyqësor nuk ka asnjë mjet tjetër ligjor për të vënë në funksionim Kolegjin Zgjedhor. Nuk mundet të ketë praktikisht, referuar Kodit Zgjedhor, asnjë mundësi, për të zgjedhur një anëtar tjetër, sikundër nuk ka

asnjë mjet tjetër që të mund të iniciohet kundër sjelljes së zotit {...} duke mos u paraqitur në detyrë. Ne thjesht kemi një situatë përballë dhe do duhet t'i japim zgjidhje edhe funksionimit të Kolegjit Zgjedhor. Edhe në rastin e dhënies së lejes prindërore, pavarësisht se leja prindërore nuk mund të mohohet, patjetër që organi që jep lejen, konsideron eficiencën e drejtësisë dhe funksionalitetin, në të kundërt nuk mund ta japë lejen nga momenti që kërkohet, pra të shtyhet, apo ta ndajë lejen në periudha të ndryshme kohore. Në rastin konkret, duke thënë që do paraqitet në detyrë gjatë periudhës kur Kolegji Zgjedhor është mbledhur, ish-Këshilli i Lartë i Drejtësisë ka konsideruar ta ndajë këtë leje, pra ta ndërpresë për një periudhë të caktuar lejen prindërore. Faleminderit!

Naureda Llagami: Atëherë, zoti Toska, me sa kuptova nga sqarimet e dhëna nga ju, ju nuk keni komente lidhur me vendimmarrjen e propozuar nga Komisioni, por keni komente lidhur me arsyetimin e bërë për këtë vendimmarrje, pra keni një linjë tjetër arsyetimi për të arritur në të njëjtën vendimmarrje.

Ilir Toska: Po! E ka cekur pak edhe vetë në propozimin e tij Komisioni i Vlerësimit Etik dhe Profesional. Thjesht unë desha të shtoja që të jem më i qartë për sa i përket arsyetimit dhe votimit tim. Faleminderit!

Naureda Llagami: Atëherë, për vendimmarrjen, ta hedhim në votim? –sepse zoti Ilir e shprehu atë mosdakordësinë tek linja e arsyetimit, ndërkohë që për vendimmarrjen, unë propozoj që të vazhdojmë me projekt-aktin e propozuar sipas Komisionit.

Brunilda Kadi: Unë mendoj që në fillim duhet të hidhet në votim propozimi që bëri zoti Toska sepse linja e arsyetimit është totalisht e ndryshme nga ajo që propozoi Komisioni, kështu që pavarësisht se dispozitivi i vendimmarrjes mund të jetë i njëjtë, arsyetimi është i ndryshëm dhe kjo e ndryshon komplet aktin, kështu që propozoj fillimisht të hidhet në votë propozimi i zotit Toska dhe pastaj propozimi i Komisionit.

Ilir Toska: Kam përshtypjen që unë nuk bëra ndonjë propozim konkret për projekt-aktin. Arsyetimi im dhe votimi im është ky që është. Nuk kam në lidhje me urdhërimin që duhet të bëjë Këshilli.

Naureda Llagami: Vazhdojmë me projekt-aktin sipas propozimi të bërë nga Komisioni. E hedhim për votim.

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Illir Toska: Dakord, por me arsytim ndryshe.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord, por edhe unë i bashkëngjitëm arsyetimit të zotit Toska.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi ndryshimin e vendimit nr. 52, datë 11.10.2018 të ish-KLD-së në pikën 1 të tij, duke shfuqizuar togfjalëshin “për funksionimin si gjyqtar pranë Gjykatës së Apelit Tiranë”. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me botimin e tij në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 1 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2019

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbajtur, më 05.06.2019)

Pika 2 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin e relatorit për verifikimin e kushteve dhe kriterëve për secilin kandidat për gjyqtar të diplomuar në Shkollën e Magjistraturës në vitin 2018”.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 15:35 dhe mbaroi në orën 16:54.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. **Naureda Llagami** (kryetare)
2. **Maksim Qoku** (zëvendëskryetar)
3. **Medi Bici** (anëtar)
4. **Fatmira Luli** (anëtare)
5. **Brunilda Kadi** (anëtare)
6. **Dritan Hallunaj** (anëtar)
7. **Ilir Toska** (anëtar)
8. **Alban Toro** (anëtar)
9. **Brikena Ukperaj** (anëtar)
10. **Erjon Muharremaj** (anëtar)
11. **Marçela Shehu** (anëtare)

Merrnin pjesë gjithashtu:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
2. *Antuen Skënderi, Këshilltare e Kabinetit pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
3. *Pjerin Prendi, Këshilltar i Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
4. *Vildan Kaloshi, Drejtor pranë institucionit.*
5. *Valbona Bako, Specialiste pranë institucionit.*
6. *Elis Kuçi, Specialist pranë institucionit.*
7. *Edlira Bako, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
8. *Migena Kondo, Komiteti Shqiptar i Helsinkit.*
10. *Klara Kodra, Qendra Evropiane.*
11. *Gregor Borgowski, EURALIUS.*
12. *Klodian Rado, EURALIUS.*
13. *Valbona Bala (Pajo), USAID.*
14. *Erion Fejzulla, USAID.*

RENDI I DITËS:

2. Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin e relatorit për verifikimin e kushteve dhe kriterëve për secilin kandidat për gjyqtar të diplomuar në Shkollën e Magjistraturës në vitin 2018”.

Naureda Llagami: Kalojmë tek çështja e dytë e rendit të ditës. Sikurse jeni vënë në dijeni, çështja e dytë ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për caktimin e anëtarit relator për verifikimin e kushteve dhe kriterëve për kandidatët për gjyqtarë të diplomuar në Shkollën e Magjistraturës në vitin 2018”.

Sikurse jeni në dijeni, Këshilli në mbledhjen e datës 23 maj, miratoi vendimin nr. 75 “Për procedurat e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë. Në këtë mënyrë, Këshilli i ka hapur rrugë edhe emërimit dhe ngritjes në detyrë të kandidatëve gjyqtarë, përfshirë këtu edhe kandidatëve për

gjqtarë të diplomuar në Shkollën e Magjistraturës në vitin 2018 dhe kandidatëve, po ashtu, që janë në programin e formimit fillestar. Për sa më sipër, Këshilli, në zbatim të rregullores së miratuar, procesin e verifikimit duhet ta bëjë Komisioni i Zhvillimit të Karrierës dhe konkretisht relatori që është anëtar i këtij Komisioni, i cili caktohet në short. Në zbatim të kësaj dispozite, Këshilli duhet të organizojë dy procese shorti. Organizimi i shortit për të përcaktuar relatorin për kandidatët për gjyqtarë të diplomuar në Shkollën e Magjistraturës në vitin 2018, të cilët janë gjithsej 10 të diplomuar. Shorti tashmë, siç jeni në dijeni është një procedurë e zakonshme e Këshillit, me të cilën jemi familjarizuar. Ai do të organizohet duke futur në dy vazo qelqi, të palosura, shirita letre. Në njërin janë emrat e anëtarëve të Komisionit për Zhvillimin e Karrierës (3 anëtarët e tij: zoti Ilir Toska, zonja Marçela Shehu dhe zoti Alban Toro), pra 3 shirita letre, ndërkohë që në vazën tjetër do të jenë emrat e 10 kandidatëve për gjyqtarë, të diplomuar në Shkollën e Magjistraturës në vitin 2018, të shkruar secili në një shirit letre, pra janë gjithsej 10 shirita letre të palosura, ku secila përmban emrat e të diplomuarve. Më konkretisht: {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...} dhe {...}. Punonjësi i administratës tërheq një shirit letre nga vazoja në të cilën ndodhen emrat e të diplomuarve në Shkollën e Magjistraturës dhe me zë lexon emrin që është shkruar dhe tregon para anëtarëve dhe pjesëmarrësve, ndërkohë tërheq edhe një shirit letre nga vazoja tjetër, në të cilën janë emrat e anëtarëve të Komisionit, duke e lexuar me zë, duke treguar emrin e shkruar në letër para anëtarëve dhe pjesëmarrësve në sallë. Ky anëtar i Komisionit i zgjedhur nga shorti, përcakton qenien e tij relator për të kryer procedurën përkatëse të verifikimit të kushteve ligjore të emërimit, riemërimit apo ngritjes në detyrë të kandidatit të zgjedhur nga shorti.

Për shkak se anëtarët e Komisionit janë 3 (tre), ndërkohë kandidatët janë më shumë, për përcaktimin relator të tyre, shiritat e letrës me emrat e tyre do të rifuten përsëri në vazo, duke rifilluar procesin e caktimit të tyre si relator, deri në përfundimin dhe caktimin e secilit kandidat relator përkatës.

Kaq ishte, për t'ju sqaruar procedurën që do të ndiqet nga administrata për pjesën e shortit për të përcaktuar relatorët për kandidatët magjistratë të 2018-ës. Nëse keni ndonjë pyetje? Po, zoti Toska!

Ilir Toska: Atëherë, meqenëse në procedurat e verifikimit do të ngarkohet Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, ne të tre anëtarët Komisionit, jemi dakordësuar me njëri-tjetrin për të shpërndarë ngarkesën e punës ku kryetari i Komisionit, kemi rënë dakord që për sa i përket procedurave të verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për kandidatët për gjyqtarë të diplomuar në Shkollën e Magjistraturës për vitin 2018, kryetari i Komisionit të marrë 2 (dy) procedura verifikimi, ndërsa dy anëtarët e tjerë të marrin secili nga 4 (katër) procedura. Meqenëse kjo është një ngarkesë që ne kemi dhe që duhet ta përballojmë ne, kërkoj që Këshilli të marrë në konsideratë këtë ndarje të punës që ne kemi bërë mes njëri-tjetrit, jo vetëm për këto procedime, por përgjithësisht për ngarkesën që vjen nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Faleminderit!

Naureda Llagami: Okej, atëherë kalojmë në votim propozimin e bërë nga kryetari i Komisionit, lidhur me shpërndarjen e ngarkesës ndërmjet anëtarëve të Komisionit përkatës? Jemi dakord me propozimin?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, të vijohet me hedhjen e shortit duke marrë parasysh propozimin e miratuar nga Këshilli mbi shpërndarjen e ngarkesës midis anëtarëve të Komisionit.

Elis Kuçi: Si fillim, po japim emrat e kandidatëve një e nga një para Këshillit:

Z. {...}, Znj. {...}, Znj. {...}, Znj. {...}, Z. {...}, Znj. {...}, Z. {...}, Znj. {...}, Znj. {...}; edhe emrat e 3 (tre) anëtarëve të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës: Znj. Marçela Shehu...

Atëherë, sipas procedurës së miratuar në Këshill, dy emrat që janë në vazon e qelqit do i përkasin kryetarit të Komisionit, zotit Ilir Toska, kurse nga katër emra, anëtarëve përkatës, zotit Toro dhe zonjës Shehu.

(Futen emrat e 3 (tre) anëtarëve të Komisionit në enën e qelqit.)

Zonja Shehu; Zoti Ilir Toska; Zoti Alban Toro.

(Përzgjidhet emri i parë i anëtarit të Komisionit.)

Anëtare e komisionit që u zgjodh është zonja Marçela Shehu, e para.

Tani do përzgjedhim 4 (katër) (është fjala për 4 magjistratë) për zonjën Marçela Shehu.

1. E para: zonja {...};

2. Zoti {...};

3. Zonja {...};

4. Në fund zonja {...}.

Mbaruam me zonjës Shehu.

(Përzgjidhet emri i dytë i anëtarit të Komisionit.)

Zoti Ilir Toska.

Zoti Toska ka 2 (dy) kandidatë.

(Përzgjidhen emrat e dy magjistratëve.)

1. Zonja {...};

2. Zoti {...}.

4 (katër) emrat e mbetur, i përkasin anëtarit... (zotit Toro).

(Lexohen emrat e katër magjistratëve të mbetur në enën e qelqit.)

1. Emrat janë: zoti {...};

2. Zonja {...};

3. Zonja {...} dhe;

4. Zonja {...}.

Shorti mbaroi.

Naureda Llagami: Po! Atëherë, sipas shortit të hedhur rezulton se relator për zotin {...} është zonja Marçela Shehu, relator për {...}n është zonja Marçela Shehu, relator për {...} është Alban Toro, relator për {...}n është zoti Alban Toro, relator për

{...}n është zoti Alban Toro, relator për {...} është zoti Ilir Toska, relator për {...} është zoti Alban Toro, relator për {...} është zonja Marçela Shehu, relator për {...} është zoti Ilir Toska dhe relator për {...} është zonja Marçela Shehu.

* * *

(Pika 2 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2019

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbajtur, më 05.06.2019)

Pika 3 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin e relatorit për verifikimin e kushteve dhe kriterëve për secilin kandidat për në formimin fillestar të Shkollës së Magjistraturës në vitin akademik 2019-2020”.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 15:35 dhe mbaroi në orën 16:54.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. *Naureda Llagami* (kryetare)
2. *Maksim Qoku* (zëvendëskryetar)
3. *Medi Bici* (anëtar)
4. *Fatmira Luli* (anëtare)
5. *Brunilda Kadi* (anëtare)
6. *Dritan Hallunaj* (anëtar)
7. *Illir Toska* (anëtar)
8. *Alban Toro* (anëtar)
9. *Brikena Ukperaj* (anëtar)
10. *Erjon Muharremaj* (anëtar)
11. *Marçela Shehu* (anëtare)

Ilir Toska: Edhe në këtë rast, ne kemi të njëjtin propozim, referuar numrit që është 28 kandidatë që duhet të verifikohen kriteret ligjore, pasuria dhe figura, kemi rënë dakord që si anëtarë të Komisionit të Zhvillimi të Karrierës, që 6 (gjashtë) nga kandidatët duhet t'i kem unë si relator, pra unë si kryetar i Komisionit, ndërsa secili nga dy anëtarët e tjerë do të kenë nga 11 (njëmbëdhjetë) kandidatë për verifikim. Faleminderit!

Naureda Llagami: Jeni dakord me propozimin e bërë nga kryetari i Komisionit?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, miratohet propozimi i kryetarit të Komisionit. Të vijohet procedura e shortit sipas propozimit të miratuar.

Elis Kuçi: Atëherë, në enën e anëtarëve vendosen tre anëtarët e Komisionit (*pra shiritat me 3 emrat e anëtarëve të Komisionit*).

Zoti Ilir Toska.

Zonja Marçela Shehu.

Zoti Alban Toro.

Tek vazo tjetër do vendosen 28 emrat e kandidatëve të formimit fillestar të Shkollës së Magjistraturës për vitin 2019-2020.

Fillojmë me emrin e parë. {...}, {...}, zoti {...}, zonja {...}, zonja {...}, zoti {...}, zonja {...}, zoti {...}, zoti {...}, zoti {...}, zoti {...}, zonja {...}, zonja {...}, zoti {...}, zoti {...}, zoti {...}, zonja {...}, zonja {...}, zonja {...}, zonja {...}, zonja {...}, zoti {...}, zoti {...}, zonja {...}, zonja {...}, zonja {...}, zonja {...}, dhe zonja {...}.

Të gjithë kandidatët janë hedhur në vazon përkatëse.

Si fillim tërheqim një nga anëtarët e Komisionit dhe më pas, bazuar në emrin, do zgjedhim edhe emrat përkatës në vazon e dytë.

(Përzgjidhet emri i anëtarit të parë.)

Zoti Alban Toro.

Për zotin Toro do tërheqim 11 (njëmbëdhjetë) kandidatë nga vazo tjetër.

1. Zoti {...}.
2. Zonja {...}.
3. Zonja {...}.
4. Zonja {...}.
5. Zoti {...}.
6. Zoti {...}.
7. Zoti {...}.
8. Zoti {...}.
9. Zoti {...}.
10. Zonja {...}.
11. Zonja {...}.

Vijojmë emrin e një anëtari të Komisionit.

(Përzgjidhet emri i anëtarit të dytë.)

Zonja Marçela Shehu.

Zonja Shehu ka 11 (njëmbëdhjetë) kandidatë.

1. Zoti {...}.
2. Zonja {...}.
3. Zonja {...}.
4. Zonja {...}.
5. Zonja {...}.
6. Zoti {...}.
7. Zonja {...}.
8. Zoti {...}.
9. Zoti {...}.

10. Zoti {...}.

11. Zoti {...}.

Mbaruam edhe me zonjën Marçela Shehu, me 11 kandidatët.

Kandidatët e mbetur i përkasin anëtarit të Komisionit të mbetur në vazo, zotit Ilir

Toska.

1. Zonja {...}.

2. Zonja {...}.

3. Zonja {...}.

4. Zonja {...}.

5. Zoti {...}.

6. Zonja {...}.

Përfundimi i shortit.

Naureda Llagami: Atëherë, si rezultat i shortit të hedhur, u caktuan relatorët si më poshtë, për këto kandidatë:

1. {...} - është relator zoti Alban Toro.

2. {...} – relator zonja Marçela Shehu.

3. {...} - relator zoti Alban Toro.

4. {...} - relator zoti Ilir Toska.

5. {...} - relator zoti Alban Toro.

6. {...} - relator zoti Alban Toro.

7. {...} - relator zonja Marçela Shehu.

8. {...} - relator zoti Alban Toro.

9. {...} - relator zoti Alban Toro.

10. {...} - relator zonja Marçela Shehu.

11. {...} - relator zonja Marçela Shehu.

12. {...} - relator zonja Marçela Shehu.

13. {...} - relator zoti Alban Toro.

14. {...} - relator zonja Marçela Shehu.

15. {...} - relator zoti Alban Toro.

16. {...} - relator zonja Marçela Shehu.

17. {...} - relator zonja Marçela Shehu.
18. {...} - relator zoti Ilir Toska.
19. {...} - relator zonja Marçela Shehu.
20. {...} - relator zoti Ilir Toska.
21. {...} - relator zoti Alban Toro.
22. {...} - relator zoti Ilir Toska.
23. {...} - relator zonja Marçela Shehu.
24. {...} - relator zonja Marçela Shehu.
25. {...} - relator zoti Ilir Toska.
26. {...} - relator zoti Ilir Toska.
27. {...} - relator zoti Alban Toro.
28. zonja {...} - relator zoti Alban Toro.

Ky vendim hyn në fuqi me botimin në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 3 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2019

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbajtur, më 05.06.2019)

Pika 4 e rendit të ditës me objekt: Caktimi i gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ato ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme” i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 15:35 dhe mbaroi në orën 16:54.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. *Naureda Llagami* (kryetare)
2. *Maksim Qoku* (zëvendëskryetar)
3. *Medi Bici* (anëtar)
4. *Fatmira Luli* (anëtare)
5. *Brunilda Kadi* (anëtare)
6. *Dritan Hallunaj* (anëtar)
7. *Ilir Toska* (anëtar)
8. *Alban Toro* (anëtar)
9. *Brikena Ukperaj* (anëtar)
10. *Erjon Muharremaj* (anëtar)
11. *Marçela Shehu* (anëtare)

Merrnin pjesë gjithashtu:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
2. *Antuen Skënderi, Këshilltare e Kabinetit pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
3. *Pjerin Prendi, Këshilltar i Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
4. *Vildan Kaloshi, Drejtor pranë institucionit.*
5. *Valbona Bako, Specialiste pranë institucionit.*
6. *Elis Kuçi, Specialist pranë institucionit.*
7. *Edlira Bako, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
8. *Migena Kondo, Komiteti Shqiptar i Helsinkit.*
10. *Klara Kodra, Qendra Evropiane.*
11. *Gregor Borgowski, EURALIUS.*
12. *Klodian Rado, EURALIUS.*
13. *Valbona Bala (Pajo), USAID.*
14. *Erion Fejzulla, USAID.*

RENDI I DITËS:

4. Caktimi i gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ato ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme” i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Naureda Llagami: Kalojmë tek çështja tjetër e rendit të ditës e cila ka të bëjë me caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ato ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme”. Për ndjekjen e procedurës dhe hedhjen e shortit, fjalën po ia kaloj kryetarit të Komisionit për Zhvillimin e Karrierës, zotit Toska.

Ilir Toska: Atëherë, ditën e sotme janë përgatitur relacionet vetëm për sa i përket kërkesave që kanë paraqitur gjykatat, të konsideruara ‘tepër urgjente’. Kërkesat e tjera që janë urgjente në një masë normale apo që nuk kanë ndonjë urgjencë të shpejtë, do trajtohen në mbledhjen e radhës.

Në këto urgjenca është përfshirë edhe një çështje e Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda, e cila ka mbërritur në Këshillin e Lartë Gjyqësor në datën 3, ndërsa është referuar nga gjykata që seanca e radhës është caktuar për në datën 6. Është një çështje për të cilën ne kemi bërë një herë short më herët për caktimin e një gjyqtari, ndërkohë që ka lindur nevoja për caktimin e një gjyqtari tjetër rishtazi.

Sa i përket radhës së procedurave të shortit, kemi propozuar që të fillojmë me Gjykatën e Apelit për Krimet e Rënda. Më pas të vijojmë me Gjykatën e Apelit Vlorë dhe në fund me Gjykatën e Apelit Korçë. Ndërkohë, sa i përket gjykatës së shkallës së parë, kemi vetëm kërkesa që janë bërë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin.

Jeni dakord me radhën e procedurave të shortit?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Alban Toro: Dakord.

Ilir Toska: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Ilir Toska: Atëherë, vazhdojmë me procedurat e shortit për secilën gjykatë.

Atëherë, procedura e parë e shortit është për nevojën që ka paraqitur **Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda.**

Siç përmenda edhe pak më parë është një nevojë që ka lindur edhe më herët. Është trajtuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor në mbledhjen e datës 20 maj 2019. Ndërkohë që gjyqtarja e caktuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor në këtë rast rezulton të jetë përjashtuar nga gjykimi i çështjes, shkak për të cilin nga Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda është paraqitur përsëri kërkesë për caktimin e një gjyqtari tjetër në një çështje penale. Edhe në këtë rast, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës bën të njëjtin propozim si

dhe në mbledhjen e datës 20 maj, sa i përket gjykatave nga duhet të përzgjidhet gjyqtari që duhet të caktohet për gjykimin e kësaj çështjeje, pra nga të gjithë gjykatat e apelit me juridiksion të përgjithshëm. Bën të njëjtin propozim sa i përket numrit të gjyqtarëve, që është 1. Po ashtu bën të njëjtin propozim sa i përket gjyqtarëve që duhet të përjashtohen nga shorti, që sipas, po ju rikujtoj edhe propozimin që është pranuar në mbledhjen e datës 20 maj 2019, që janë kryetarët e gjykatave të apelit me juridiksion të përgjithshëm, anëtarët e Këshillit të Emërimeve në Drejtësisë, gjyqtarët që u është rakorduar leje afatgjatë nga ish-KLD, gjyqtarët e seksionit civil të Gjykatës së Apelit Tiranë, gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Tiranë që është në prag të mbushjes së moshës së pensionit të pleqërisë dhe gjyqtarët që janë nën procedim penal përpara juridiksionit të gjykatave të krimeve të rënda.

Jeni dakord me ripropozimin e bërë nga Komisioni?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Alban Toro: Dakord.

Ilir Toska: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Ilir Toska: Në këtë rast kemi vetëm një shtesë të propozimit, për sa i përket përjashtimit të gjyqtarës {...} që është përjashtuar nga procedurat gjyqësore të ndjekura në këtë rast, si dhe sa i përket anëtarëve të Kolegjit Zgjedhor, në kushtet kur Kolegji Zgjedhor është thirrur në detyrë dhe është aktualisht i mbledhur. Tre anëtarët e Kolegjit që janë gjyqtarë të gjykatave me juridiksion të përgjithshëm që janë: zoti {...}, zoti {...} dhe zoti {...}. Pra edhe për këta gjyqtarë kemi propozuar përjashtimin e tyre nga shorti.

Jeni dakord me këtë propozim?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Alban Toro: Dakord.

Ilir Toska: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Ilir Toska: Mirë atëherë, do fusim në enë të gjithë emrat e gjyqtarëve të gjykatave të apelit me juridiksion të përgjithshëm, duke përjashtuar ata që më lart vendosëm t'i përjashtojmë nga shorti.

Atëherë, po fusim emrat e gjyqtarëve. Emri i parë është {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...} (që janë gjyqtarë të Gjykatës së Apelit Tiranë).

Vazhdojmë me Gjykatën e Apelit Vlorë – {...}, {...}, {...}, {...}.

Vazhdojmë me emrat e gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit Shkodër – {...}, {...}, {...}, {...}, {...}.

Vazhdojmë me emrat e gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit Korçë – {...}, {...}, {...}.

Vazhdojmë me emrat e gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë – {...}, {...}, {...}, {...}.

Në fund janë emrat e gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit Durrës – {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}.

Këta janë emrat e gjyqtarëve mes të cilit do të përzgjedhim njërin prej tyre.

(Përzgjidhet gjyqtarja {...}.)

{...} është emri i përzgjedhur nga shorti për t'u caktuar në Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda

Me kaq mbyllet shorti për Gjykatën e Apelit për Krimet e Rënda.

Vazhdojmë me shortin për **Gjykatën e Apelit Vlorë**. Gjykata e Apelit Vlorë ka paraqitur nevojë, të natyrës ‘tepër urgjente’, për dy çështje penale. Ndërsa nuk mund të zbatohet mekanizmi i skemës së delegimit dhe i transferimit të përkohshëm të një gjyqtari, për shkak të numrit të ulët dhe të mosfunksionimit të skemës së delegimit, kemi propozuar që të zbatohet vendimi i Këshillit të Lartë të Drejtësisë “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”. Në këtë kuadër kemi propozuar që gjykata nga duhet të përzgjidhen me short gjyqtarët që do caktohen për gjykimin e dy çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë Gjykata e Apelit për Krime të Rënda, ndërsa numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e këtyre dy çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë 3 (tre), për sa kohë një prej çështjeve për të cilat paraqet nevojë Gjykata e Apelit Vlorë, kërkohen 3 (tre) gjyqtarë. Jeni dakord me këtë propozim?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Alban Toro: Dakord.

Ilir Toska: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Ilir Toska: Mirë atëherë, do të fusim në një enë emrat e gjyqtarëve të apelit për krimet e rënda. Në këtë rast kemi propozuar që të përjashtohen nga shorti kryetarja në detyrë e Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda, zonja {...}, si dhe anëtari i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, zoti {...}.

Besoj jeni dakord.

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Alban Toro: Dakord.

Ilir Toska: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Ilir Toska: Mirë atëherë, hedhim në një enë emrat e gjyqtarëve dhe në një enë tjetër dy numrat që kemi për shortim (çështja nr. 1 dhe çështja nr. 2).

Emrat e gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda mes të cilëve do të bëhet shorti janë: {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...} dhe {...}.

Shortin do e hedhim për çështjen nr. 1 për të cilën kërkohet caktimi i 3 (tre) gjyqtarëve. Do të përzgjedhim emrat e 3 gjyqtarëve që do të caktohen për çështjen nr. 1, ku emri i përzgjedhur i pari është njëkohësisht edhe relatori i çështjes. Vazhdojmë shortin.

Emri i parë është gjyqtari – {...}, i cili caktohet për çështjen nr. 1, edhe si relator i çështjes.

Emri i dytë është i gjyqtarit – {...}, që caktohet anëtar për çështjen nr. 1.

Emri i tretë është i gjyqtarit – {...}, që edhe ai caktohet si anëtar për çështjen nr. 1.

Sa i përket çështjes tjetër, pra çështjes nr. 2, kërkohet caktimi i një gjyqtari. Kemi propozuar që të përzgjidhet me short mes 3 gjyqtarëve të përzgjedhur për çështjen nr. 1. Jeni dakord me këtë propozim?

Mirë atëherë fut në një enë emrat e 3 gjyqtarëve të përzgjedhur për çështjen nr. 1, me qëllim për të përzgjedhur njërin prej tyre që të caktohet për çështjen nr. 2.

Atëherë, emri i gjyqtarit të përzgjedhur është {...}, i cili caktohet për çështjen nr. 2 për të cilën kërkohet 1 gjyqtar.

Me kaq mbyllet procedura e shortit për Gjykatën e Apelit Vlorë.

Vazhdojmë me procedurën e shortit për **Gjykatën e Apelit Korçë**. Gjykata e Apelit Korçë ka paraqitur nevojë për 1 çështje gjyqësore të natyrës ‘tepër urgjente’. Është çështje penale. Kemi propozuar që në zbatim të vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për procedurat dhe rregullat e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”. Gjykata nga duhet të përzgjidhen me short gjyqtarët që do caktohen për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë Gjykata e Apelit Shkodër dhe numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë 3, sikurse na kërkohet nga Gjykata e Apelit Korçë. Jeni dakord?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Ilir Toska: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Pro.

Ilir Toska: Atëherë, për ekonomizim të burimeve njerëzore, kemi propozuar që gjyqtarët e apelit Shkodër, nga duhet të përzgjidhen emrat e 3 prej tyre, të konsiderohen nga gjyqtarët që kemi caktuar më herët në Gjykatën e Apelit Korçë. Në dy raste short janë caktuar 6 gjyqtarë të Gjykatës së Apelit Shkodër. Kemi propozuar që 3 gjyqtarët që duhen edhe për këtë çështje që paraqet nevojë ‘tepër urgjente’, të jenë 3 prej këtyre që kemi zgjedhur më herët me short. Jeni dakord?

(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)

Ndërkohë kemi propozuar përjashtimin nga shorti të kryetarit të Gjykatës së Apelit Shkodër, zotit {...}, po kështu edhe gjyqtarit që është edhe anëtar i Kolegjit Zgjedhor që është zoti {...}. Jeni dakord?

(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)

Dakord.

Atëherë, do të hedhim në një enë emrat e 4 gjyqtarëve të mbetur të Gjykatës së Apelit Shkodër, për të përzgjedhur emrat e 3 prej tyre. Emrat që duhet të fusim në një enë janë zonja {...}, {...}, {...} dhe {...}.

{...}, {...}, {...} dhe {...}.

Do të përzgjedhim një prej tyre. Emri i përzgjedhur i pari do të jetë njëkohësisht edhe relator i çështjes.

Është {...}, i cili është edhe relator për këtë çështje.

Vazhdojmë shortin.

{...} dhe {...}. Me kaq mbyllen procedurat e shortit për Gjykatën e Apelit Korçë.

Vazhdojmë me gjykatën e fundit që është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin. Ka paraqitur nevojë për 2 çështje të natyrës ‘tepër urgjente’ për 2 çështje penale. Kemi propozuar që edhe të zbatohet vendimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për rregullat dhe procedurat e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”, ku në këtë kuadër kemi propozuar që gjykata nga duhet të përzgjidhen me short gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 2 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 2 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë 1. Jeni dakord për këtë?

Maksim Qoku: Dakord.

(Vota e zonjës Kadi nuk dëgjohet.)

Dritan Hallunaj: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Ilir Toska: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Ilir Toska: Atëherë, referuar edhe natyrës së çështjeve që janë të karakterit penal, përveçse objekti i çështjeve është për sa i përket masave të sekuestros të ndërmarra nga prokurori gjatë hetimeve paraprake, kemi propozuar që emrat e gjyqtarëve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë të përzgjidhen nga gjyqtarët e seksionit penal të hetimeve dhe seancës paraprake të kësaj gjykate, duke përjashtuar në këtë rast të gjithë gjyqtarët e këtij seksioni që janë caktuar më herët nga Këshilli i Lartë Gjyqësor në 2 apo më tepër çështje gjyqësore (pra për efekt të shpërndarjes së ngarkesës mes gjithë gjyqtarëve të këtij seksioni të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë). Po ashtu kemi propozuar të përjashtohet nga shorti një prej gjyqtarëve të këtij seksioni, që është zonja {...} (e cila është me leje lindjeje). Pra në tërësi kemi propozuar që të përjashtohen këta gjyqtarë të këtij seksioni: {...}, {...}, {...}, {...}, {...} dhe {...}. Këta të fundit janë caktuar në dy apo më tepër çështje gjyqësore më herët nga Këshilli i Lartë Gjyqësor. Ndërkohë, në seksionin penal të hetimeve dhe seancës paraprake të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, sipas informacionit të dërguar nga kjo e fundit, bëjnë pjesë këta gjyqtarë: {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...} dhe {...}. Jeni dakord me propozimin?

(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)

Dakord.

Atëherë, fusim në një enë emrat e të gjithë gjyqtarëve të seksionit penal të hetimeve dhe seancës paraprake, duke hequr ata që janë përjashtuar.

Emri i parë është i gjyqtarit {...}. I dyti, {...}. I treti, {...}. I katërti, {...}. I pesti, {...}. I gjashti, {...}.

Duhet të përzgjedhim njërin prej tyre që do të caktohet në 2 çështjet në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kurbin – Është {...}.

Me kaq mbyllen procedurat e shortit edhe për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kurbin.

Naureda Llagami: Faleminderit!

Atëherë, duke qenë se çështja e fundit e rendit të ditës është një çështje që ka informacion të klasifikuar, ju lutem të gjithë të pranishmit i ftoj që të dalin nga salla dhe ju falënderoj për prezencën tuaj. Sikurse edhe tek pjesa e stenografisë, të qëndrojnë ato persona të cilët janë të pajisur me certifikatë sigurie.

* * *

(Pika 4 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor